

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Intervista në SYRI TV - 'Në emër të Këshillit Bashkiak, por firmat janë të PS'/ Alimehmeti: Rama e futi Ve liajn në burg, Rama e mban
ADRESA	https://www.syri.net/politike/919529/ne-emer-te-keshillit-bashkiak-por-firmat-jane-te-ps-alimehmeti-rama-e-futi-veliajn-ne-burg-rama-e-mban/
BURIMI	syri.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	27 shtator 2026, 16:09:11 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	27 shtator 2026, 16:04:14 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	87bdedceab6932ebfbbfbcaccd616ad1ebc321daacc7793ae5e08326c4edd74e
TEKSTI	78993fdd3dafcefa9d39ec370d7779a9a6aa6bcea772502807b7514777ab5421
PAMJA	0372ae2e4f170527d106cb5fcf660d1feb266dfaca4bcc6ec4879a2025aeab6c

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	90b66b0e3116bae9248729a3c3cf366f6568de3a6118da7c3f8a96e743c784bf
E MËPARSHMJA	—
RRËNJJA MERKLE	9c79dfe18abd067ab8b189d0d92c4d66095ab349897e5facabd5b8506753a66f
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/90b66b0e3116bae9248729a3c3cf366f6568de3a6118da7c3f8a96e743c784bf>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



FATMIR MEDIU

Rama heshti për Kosovën në OKB, nuk iu kundërvu Vuçiçit dhe zgjodhi të flasë për Diellën



NDRIM KULLA

Dorëheqja e Ramës, kërkesë edhe e ndërkombëtarëve

LAJMI I FUNDIT

SYRI I BOTËS/ Deti i kuq dhe nafta 'e zezë' shqiptare

më të lexuarat

'Iu hoq cipa e maskës mazhorancës', Goxhaj: Po i vjen fundi kësaj kaste, Rama s' menaxhon dot më


VIDEO/ Balliu: A ka folur Edi Rama me Ergys Agasin përmes telefonit të Vlora Hysenit?

Berisha: Vlora Hyseni është kthyer për t'u dhënë restin bashkëpunëtorëve të vet që e tradhtuan

'Garancia e plotë' e Ramës dhe përgjegjësia e tij politike për Vlora Hysenin

Fjalimi i turpshëm në OKB/ Berisha: Rama, armik i egër i Kosovës, tani po përhap shpifje të ulëta kundër VV-së

'Zullumi po e kap për fyti Ramën', Noka në Tepelenë: Skandalet e kanë zhveshur



'Në emër të Këshillit Bashkiak, por firmat janë të PS'/ Alimehmeti: Rama e futi Veliain në burg, Rama e mban

18:04, 27/09/2026

ZMADHO TEKSTIN



"Në emër të Këshillit Bashkiak", por firmat janë të këshilltarëve të PS-së. Kështu e cilëson Ilir Alimehmeti, këshilltar bashkiak i opozitës në Tiranë, atë që e quan një tjetër përpjekje të socialistëve për të fshehur përgjegjësinë politike pas një institucioni kolektiv.

Në një deklaratë për Syri TV, me moderator Edvin Parrucën, Alimehmeti e vë theksin te absurdi i thirrjes së kryebashkiakut të arrestuar Erion Veliajt për të qenë i pranishëm në sallën e Bashkisë, ndërsa kërkesa mban firmat e këshilltarëve të PS-së dhe paraqitet publikisht si kërkesë "në emër të Këshillit Bashkiak". Ai thotë se të njëjtat firma janë përdorur më herët edhe për shkarkimin e Veliajt, duke ngritur pikëpyetje mbi qëndrimet dhe përgjegjësinë e këshilltarëve socialistë.

Alimehmeti: Është e disata herë që PS fshihet pas gishtit, thotë 'kërkesë në emër të Këshillit Bashkiak' por nuk është e vërtetë pasi është kërkesë e PS. Këshilltarët e PS kanë firmosur në këtë kërkesë. Ishin po të njëjtë këshilltarë të PS që kurrë nuk kanë ngritur Komisionin e Kontrollit të Brendshëm Financiar të bashkisë sa kohë ishte Erion Veliajt aty duke e lënë të vijonte abuzimet. Ishin po të njëjtë këshilltarë bashkiak të PS që votonin dhe nuk bënë asnjë pyetje se ku shkonin paratë e shqiptarëve dhe pse abuzoheshin në këtë mënyrë. Ishin po të njëjtë këshilltarë bashkiak të cilët kur i kërkuam që të bëhej mbledhje e jashtëzakonshme kur arrestua Veliajt që të flasim si do të drejtohej kjo bashki, nuk e bënë kurrë. Ishin po të njëjtë këshilltarë të PS që me urdhër të Ramës në selinë e PS u detyruan që të firmosnin për shkarkimin e Erion Veliajt dhe ishin po të njëjtë këshilltarë të PS që mban Gjykata Kushtetuese, pastaj u shpreh filluan të kërkonin që ai të ishte i pranishëm në sallë. Janë puro vegla si të dojë Edi Rama t'i sjelli kështu rrotullohen edhe ata dhe vejnë firmat herë për shkarkim dhe herë për afirmim të kryetarit të bashkisë pasi derisa Gjykata Kushtetuese e mban në pozicionin e kryetarit të bashkisë, ne kështu do ta quajmë.

E gjitha kjo ndodh në kurrizin tonë, të qytetit dhe në kurriz të qytetarëve të

Tiranës. Nuk na intereson a është i pranishëm apo nuk është i pranishëm, a do e nxjerri apo s'do e nxjerri, pasi të jemi të qartë, Edi Rama e futi Brenda, Edi Rama e mban.

Në këtë moment ne kemi një qytet që për shkak të abuzimeve që ka bërë PS me eksponentët e saj Rama dhe Veliaj dhe për shkak të situatës së abuzimit kaq të madh që ka bërë dhe për shkak të kësaj situatë të kapjes së drejtësisë që nuk dinë si ta sjellin, kanë krijuar një situatë që kryetari i bashkisë është në burg, po nga krahut tjetër është në fuqi por nga krahut tjetër nuk ka një nënkryetar deleguar me fuqi për të ecur përpara bashkia dhe bashkia dhe të gjithë ne kemi ngecur. Janë bllokuar të gjitha të dhënat. Dhe kjo nuk është çështja që do jetë apo nuk do jetë i pranishëm në mbledhje. Në mbledhje ka detyrim të jetë i pranishëm një person që përfaqëson ekzekutivin, o kryetari i bashkisë o një nënkryetar i deleguar me firmën e tij, pasi ne kemi pyetje për të bërë, diskutime, duhet të mbajë përgjegjësi ky person që për hir të tij dhe për stafit të tij, kjo Tiranë është këtu ku është. Pastaj ta zgjidhi ligji se kush është i pranishëm.

Kjo tregon shumë qartë frikën që kanë dhe ngurrimin që ka PS dhe këshilltarët e PS që thonë 'në emër të Këshillit Bashkiak'. Jo është e pavërtetë dhe e padrejtë që Megi Fino që është kryetare e Këshillit Bashkiak ta përdori këtë term. T'i bëjë të qarta firmat, t'i shohin të gjithë emrat e njerëzve që kanë firmosur dhe ballafaqoheni me firmat e emrave që kanë kërkuar shkarkimin e Erion Veliajt. Do vini re që janë po të njëjtat firma, që do të thotë që në varsi si firshkëllen Edi Rama dhe këta shkojnë nga mbrapa.

© SYRI.net

Lexo edhe:



Rama anuloi konferencën, Noka: Duhej të jepte llogari për emërimet e tij, iu tremb pyetjeve për SHISH-in dhe Vlora Hysenin



SYRI TV/ Skandali i SHISH, Rama largon përgjegjësinë nga vetja: Përgjegjësia është individuale



VIDEO/ Mal Berisha-Ramës: Të quash Biden tradhtar është fyese, ai është një nga mbështetësit më të mëdhenj të Kosovës

Udhëtim

Berisha: Rama kërkon t'i paraqesë shqiptarët si antisemitë, terroristë e çdo gjë tjetër vetëm që të qëndrojnë në pushtet

Berisha: Sulmi i Ramës ndaj Joe Biden për dënimin e Thaçit është një paturpësi ekstreme

'Qeveria braktisi qytetarët përballë çmimeve', aktivisti: Shqipëria mban TVSH-në 20% për shportën bazë

TË NGJASHME



VIDEO/ Abilekaj: Rama shmangu gazetarët që të gënjenje, monologu mënyra për të mos iu përgjigjur pyetjeve



Shkullaku ironizon Ramën: Pas 28 vitesh në pushtet, paska dalë më i varfër se sa ka hyrë



Hoti ironizon Ramën: Ministri s'mban përgjegjësi për drejtorin, Kryeministri për ministrin, askush nuk mban përgjegjësi për qeverinë



Spahia: Teatri i Ramës mori fund, i vetmi akt është dorëheqja!



'Rama, kumbari i marrëveshjes SHISH-krim'/ Balliu: Kryeministri kërcënoi mediat, njësoj si Vlora Hyseni!



Blushi: Rama firmosi në shkelje të ligjit për inceneratorët, ja dy rastet që e implikojnë



Skandali i rëndë i SHISH, Edi Rama nuk mban asnjë përgjegjësi dhe fajëson SPAK e mediat opozitare!

LAJME POLITIKË KRONIKË EKONOMI KOSOVA BOTË KULTURË SHKENCË SPORT JETË/STIL TRASHËGIMI MIEDIS ARKIVA



SYRI.net është agjencia më e madhe e lajmeve në Shqipëri, që brenda një kohe të shkurtër është kthyer në lider të informacionit. Në SYRI.net do të gjeni opinionistë më me emër në vendin tonë, investigime dhe lajme që nuk do ti gjeni diku tjetër. Lajmet në SYRI.net janë prodhim i SYRI.net dhe nuk lejohet marrja e tyre pa një komunikim të mëparshëm me redaksinë. Ju ftojme të klikoni dhe të na shkruani sa herë që ju mendoni se duhet. Stafi i SYRI.net

Për informacione info@syri.net, për reklama marketing@syri.net



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.